



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
ËKomuna e Drenasit  
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme  
Zyra e Prokurimit  
611-21-3633-5-3-6/C441



## K O N T R A T Ë P U N E

Emri i Projektit: **PASTRIMI I DEPONIVE TE EGRA - FAZA E DYTE**

Numri identifikues: **611-21-066-536**, Datë: **15.07.2021**; Nr. i arkivit: **400-32361**

### PALËT NË MARRËVESHJE

**KOMUNA E DRENASIT** - Drenas, përfaqësuar nga **MENSUR GLLAREVA** Zyrtar i Prokurimit ( më tutje "Punëdhënës").

" **DESHISHKU GB SH.P.K** përfaqësuar nga **GENTIAN DESHISHK** , Drejtor (më tutje kontraktuese).

#### Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **PASTRIMI I DEPONIVE TE EGRA - FAZA E DYTE**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të **punëve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup>. Periudha e kryesë se **punëve** do të jetë deri në afatin : **10 dite**.

#### Neni 3 Çmimi

Çmimi i punëve është në shumën prej: **2 777,00 €**; Dymijë e Shtatëqind e Shtatedhjetë e Shtatë euro )

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetinja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

#### Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton Menaxheri i projektit, duke mos e tejkaluar shumën prej: **2 777,00 €**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e

pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Kryetari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësiti kërkuese. Afati i kryerjes së **punëve** duhet të jetë brenda **6 MUAJ** . Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DRKS

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **punëve** të kryera do të caktohet nga menaxheri i kontrates. Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga menaxheri i kontrates.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **punëve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimi, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit., dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga DRKS.

## **Neni 7 Garancioni i punëve**

7.1 Nuk ka .

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [ të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[punëve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

**11.1** Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

**12.1** Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

**13.1** Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





**13.2** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

## Neni 14 Komunikimi

**14.1** Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe paralogaria e ofertuesit. **Kontrata hynë 19.17.2021 deri me 31.12.2021**

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	MENSUR GLLAREVA	Emri:	GENTIAN DESHISHK
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR SHPK
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.07.2021	Data:	16.07.2021
Vula:		Vula:	

**Paramasa dhe Paralogaria për eliminimin (largimin) e Deponive të egra me mbeturina të Amvisërisë dhe Inerte (Nderitime)- faz e dytë**

Nr. rendor	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
<b>1</b>	<b>PASTRIMI I MBETURINAVE TË AMVISRISË</b>				
1.1	Pastrimi i sipërfaqeve dhe brezeve rugore nga mbeturinat e ambisëris ( leter, shishe, qese, etj), ku ato do të mbledhen me dorë, e në disa raste mundë të grumbullohen edhe me lug ngarkuese kur sasia e tyre është e madhe , futen në thasë plasik, ngarkohen dhe transportohen deri në deponi të mbeturinave të amvisërisë që është e lejuar apo liqencuar nga MMPH-ja.. Operatori ekonomik duhet të jetë i liqencuar ose të duhet të ketë dëshmi ( kontratë) lidhur me deponimin e kelyre mbeturinave të amvisërisë,) me ndonjë kompani të liqencuar të menagjimit të mbeturinave apo të deponive të mbeturinave. Në qmim të llogaritet edhe pagesa për mbeturina që duhet të depozitohen në Deponi.Vëretje:Sasia e mbeturinave të deponuara në deponin e Liqencuar duhet të dëshmohet me faturë.	ton	40.00	26.00	1,040.00
				Gjithsej:	1,040.00
<b>2</b>	<b>PASTRIMI I MBETURINAVE INERTE(NDERITMORE)</b>				
2.1	Pastrimi,Mbledhja, ngarkimi dhe transporti i mbeturinave inerte( nderitime) deri ne deponin e mbeturinave Inerte ( nderitime ) , në Komoran IV. Vëretje:Në lokacionet ku bëhet pastrimi dhe ngarkimi nga mbeturinat inerte, duhet që tereni të rrafshohet gjatë ngarkimit	m²	800.00	1.55	1,240.00
				Gjithsej:	1,240.00
<b>3</b>	<b>RRAFSHIMI I TERENIT TË MBETURINAVE INERTE(NDERITMORE)</b>				
3.1	Rrafshimi i terrenit nga mbeturina inerte me Greder apo eskavator me lug ngarkuese apo bulduzher,në ato vende ku ka hapsirë dhe nuk e pengon ambientin për rrethë.	m²	2,485.00	0.20	497.00
				Gjithsej:	497.00
	<b>REKAPITULLIMI</b>				
1	PASTRIMI I MBETURINAVE TË AMVISRISË				1,040.00
2	PASTRIMI I MBETURINAVE INERTE(NDERITMORE)				1,240.00
3	RRAFSHIMI I TERENIT TË MBETURINAVE INERTE(NDERITMORE)				497.00
	<b>TOTALI</b>				<b>2,777.00</b>

Operatori ekonomik duhet të plotsoj keto kritere

1. Te ketë makineri për largim, bartje dhe rrafshim të terrenit ( T'i referoheni Përshkrimit teknik për detaje)
- 2.Të jetë i liqencuar për menaxhim të mbeturinave ose të ketë kontratë për deponim të mbeturinave të amvisëris me kompani të liqencuar për menagjim të mbeturinave
- 3.Plani dinamik per eliminimin e deponive është përgjat vitit kalendarik 2021 , nga dita e neshkrimit të kontrates.

